REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr.3875/9 Prot. Pogradec, më 28.10.2026

VENDIM

Nr.129 ,Datë27.10.2026

PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. FISNIK MAHMUTLLARI, LAGJA 1, BASHKIA POGRADEC, PËR SHKAK TE DEMTIMIT TE BANESES NGA RËNIA E ZJARRIT.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 107/2016, "Për Veteqeverisjen Vendore", të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të z. Fisnik Mahmutllari, për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 24.09.2026.
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së z. Fisnik mahmutllari ndihmën emergjente në vlerën prej masën **31891.3Lek** (Tridhjete e nje mije e teteqind e nentedhjete e nje) nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimit, Pronesise dhe Bashkepronesise, Administrimit te Tokës dhe

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Supervizimit te Sherbimeve, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 27 **vota**

2.Vota Pro 27

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 28.10.2026

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com